



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 55 regjistër (JR)
Datë 07.12.2020

Nr. 46 i vendimit
Datë 01.12.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 01.12.2022, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 270, datë 03.07.2020.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Aneksi Kushtetues; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, të paraqitura në ankim, e cila përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit nr. 270, datë 03.07.2020, të Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe pushimin e shqyrtimit të procesit të rivlerësimit në ngarkim të saj, dëgjoi gjyqtaren relatores Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Procesi i saj i rivlerësimit i është nënshtruar shortit të datës 15.12.2019.
2. Nga aktet e administruara në dosje, ka rezultuar se znj. Shpresa Beçaj është emëruar në detyrën e gjyqtares në vitin 1987, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh. Në muajin nëntor të vitit 1990 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe më datë 25.04.1994, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit i është propozuar Kuvendit si anëtare e Gjykatës së Lartë nga Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 4156, dhe me vendimin e Kuvendit nr. 128, datë 23.03.2004, “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë”, është emëruar në cilësinë e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Me dekretin nr. 5913, datë 08.10.2008, të Presidentit të Republikës, i është propozuar Kuvendit që subjekti i rivlerësimit të ushtronte funksionin e kryetares së Gjykatës së Lartë, propozim për të cilin Kuvendi ka dhënë pëlqimin dhe ka vendosur emërimin e saj si kryetare e Gjykatës së Lartë. Këtë detyrë e ka ushtruar deri në përfundim të mandatit 9-vjeçar, më datë 23.03.2013, sipas nenit 136, pika 3 e Kushtetutës¹ [në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve] dhe ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar (në vijim “ligji nr. 8588/2000”).
3. Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, pas përfundimit të mandatit të anëtares së Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 25² të ligjit nr. 8588/2000, më datë 10.10.2013 ka paraqitur kërkesën pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), për emërimin e saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, regjistruar me aktin nr. {***}, datë 10.10.2013.
4. Siç referon Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), kërkesa e znj. Beçaj nuk është shqyrtuar nga KLD-ja, për pasojë nga data 23.06.2013 – 30.06.2016, është trajtuar me pagesë kalimtare përgjatë kësaj periudhe. Me përfundimin e trajtimit me pagesë kalimtare, znj. Beçaj ka nisur të ushtronte aktivitet privat, me objekt aktiviteti, ndër të tjera edhe *ofrimin e konsulencës ligjore dhe përfaqësimin ligjor të palëve në gjykatë*.
5. Duke mos pasur trajtim të kërkesës për emërim si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 16.01.2016, subjekti ka paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke paditur KLD-në, me objekt padie: *Detyrimin e KLD-së për të më rehabilituar statusin tim si gjyqtare karriere, duke shqyrtuar kërkesën time dhe të nxjerrë aktin e emërimit si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, shpërblimi i dëmit [...]³.*

5.1 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, më datë 26.07.2016, me vendimin nr. {***}, ka vendosur:

¹ 3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi.

² Me plotësimin e mandatit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 136, pika 3 e Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, me kërkesën e tij, emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.

³ Shkresa e KLGj-së nr. {***} prot., datë 24.02.2020, “Kthim përgjigjeje”.

- a. *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë [...].*
- b. *Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses Shpresa Beçaj, për t'u emëruar si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.*
- c. *Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve [...].*

5.2 Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit nga të dyja palët në proces. Me vendimin e formës së prerë nr. {***}, datë 05.04.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, znj. Beçaj iu njoh e drejta për t'u emëruar në detyrë, që buronte nga pasja e statusit sipas nenit 25 të ligjit nr. 8588/2000, dhe KLD-ja, me vendimin nr. 34, datë 07.05.2018, "Për zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për zonjën Shpresa Beçaj", ka emëruar subjektin e rivlerësimit në detyrën e "Gjyqtarit", pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar dhe dorëzuar formularin për kontrollin e pastërtisë së figurës, formularin e vlerësimit profesional dhe deklaratën e kontrollit të pasurisë, sipas shtojcave të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016 dhe, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e këtij ligji. Konkretisht, nga hetimi ka rezultuar se:

6.1 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK"), me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2020, është shprehur se *znj. Shpresa Beçaj nuk ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në DSİK.*

6.2 Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.02.2020, "Kthim përgjigjeje", ka bërë me dije Komisionin, ndër të tjera se: *[...] në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, gjyqtare Shpresa Beçaj nuk ishte një gjyqtare në ushtrim detyre. [...] Me hyrjen në fuqi të ligjit nga ana e Inspektoratit të KLD-së, është proceduar hapja e një regjistri të posaçëm manual, ku janë hedhur të dhënat mbi subjektin dhe dokumentacionin e dorëzuar. Duke iu referuar të dhënave në regjistrin e posaçëm të administruar në KLD dhe tashmë pranë KLGj-së, rezulton se në periudhën 21.10.2016 – 31.03.2017, nuk rezulton të jenë depozituar formularë dhe dokumentacion shoqërues për vlerësimin profesional nga znj. Shpresa Beçaj.*

6.3 Konstatohet se në dosjen hetimore të Komisionit, nga ILDKPKI-ja nuk është përcjellë informacion për subjektin e rivlerësimit.

7. Pas kryerjes së procedurave administrative nga ana e Komisionit, më datë 01.07.2020, është zhvilluar seanca dëgjimore. Në këtë seancë ka marrë pjesë subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, së bashku me përfaqësuesin e saj ligjor, av. J. Mërtiri. Kërkimet e saj përpara Komisionit kanë konsistuar në faktin që *paçka se e konsideronte veten gjyqtare, ajo nuk ka qenë në ushtrim të detyrave, pasi ishin organet shtetërore ato që nuk kishin nxjerrë aktin e emërimit në detyrë.* Duke theksuar po ashtu, që vullneti i saj ishte që të rivlerësohej si gjyqtare, dhe jo si ish-gjyqtare (*për këtë arsye, arsyeton subjekti, nuk ka paraqitur kërkesë sipas nenit 179/b/4 të Kushtetutës*). Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, pretendon se ka ndërmarrë hapat për plotësimin e deklaratave, duke u paraqitur pranë ILDKPKI-së, por është gjendur në situatën që, sipas saj, i është komunikuar verbalisht se nuk e ka emrin në listat e përcjella nga organet kompetente. Konkretisht, subjekti është shprehur se: *[...] me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, unë jam paraqitur personalisht pranë ILDKPKI-së, për plotësimin dhe dorëzimin e tre formularëve sipas ligjit, por kam marrë përgjigje se nuk isha pjesë e subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji pasi në rakordim me listat përkatëse të dorëzuara nga institucionet, emri im nuk figuronte në to.*

7.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me problematikat e evidentuara, ka paraqitur në Komision shpjegimet e saj, si dhe provat shkresore.

7.1.1 Në vijim të hapave hetimorë të ndërmarrë, Komisioni, pasi ka përcjellë pyetësoin në janar të vitit 2020 dhe ka marrë përgjigjet përkatëse, më datë 05.03.2020, ka mbyllur fazën hetimore, dhe në datën 10.03.2020, ka njoftuar subjektin mbi mbylljen e hetimit administrativ, duke e ftuar të njihej me dosjen dhe të paraqiste shpjegimet. Subjekti është njohur me dosjen dhe ka paraqitur pranë Komisionit me shkrim, edhe “Shpjegime shtesë”.

7.1.2 Komisioni, në datën 28.05.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ka njoftuar znj. Shpresa Beçaj për caktimin e seancës dëgjimore më datën 03.06.2020.

7.1.3 Me e-mail-in e datës 17.06.2020, znj. Shpresa Beçaj ka konfirmuar personalisht mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit dhe i ka bërë me dije Komisionit se pavarësisht gjendjes jo të mirë shëndetësore, ishte në dispozicion për t’u paraqitur në seancë që mund të caktohej kur të çmohej nga trupa.

7.1.4 Në mbledhjen e datës 25.06.2020, Komisioni ka caktuar më 1 korrik 2020 seancën dëgjimore dhe ka riftuar znj. Shpresa Beçaj që të paraqitej për të dhënë argumentet dhe shpjegimet e saj.

7.2 Pas seancës dëgjimore, në bazë të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës që sanksionon se: *Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra [...]*, si dhe të pikës 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet [...]*, Komisioni ka marrë vendimin e shkarkimit nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

- 8.** Komisioni, me vendimin nr. 270, datë 03.07.2020, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit, Tiranë.* Ky vendim është marrë pasi është konstatuar se nga subjekti i rivlerësimit nuk janë dorëzuar deklaratat dhe formularët sipas shtojcave të ligjit nr. 84/2016, dhe pasi Komisioni ka hetuar në drejtim të institucioneve të ngarkuara/ndihmëse, ka konkluduar:

8.1 Në lidhje me statusin funksional: [...] *ka rezultuar se znj. Shpresa Beçaj – [...] pasi ka përfunduar mandatin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, ka ruajtur në vijimësi statusin e gjyqtares, ndonëse riemërimi i saj ka rezultuar i vonuar, duke krijuar një shkëputje të vijimësisë së kryerjes së funksionit konkretisht, për sa kohë është kryer në një distancë kohore disavjeçare [...].*

8.2 Lidhur me detyrimet që ka passjellë pasja e statusit të gjyqtarit: [...] *znj. Shpresa Beçaj, në momentin e futjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte një subjekt që duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit ex officio, për shkak të statusit që gëzonte dhe, për rrjedhojë, mbartte edhe detyrimin ligjor të përcaktuar në nenet e mësipërme, për paraqitjen e deklaratës së pasurisë, të deklaratës për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, brenda afatit 30-ditor, nga hyrja në fuqi e tij [...].*

8.3 Lidhur me shkaqet e mospërbushjes së detyrimeve ligjore dhe pasojat që rrjedhin: [...] *znj. Shpresa Beçaj nuk e ka përbushur asnjërin prej detyrimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 31, 35 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me paraqitjen e dy deklaratave dhe të formularit të sipërcituar. Ky fakt është konfirmuar fillimisht nga institucionet përkatëse dhe më pas është pranuar edhe nga subjekti, e cila ka shpjeguar arsyet e mosparaqitjes së tyre në shpjegimet e përshkruara në pjesën e parë të këtij vendimi (pika 8). Nisur nga sa më lart, Komisioni duhet të*

mbajë në vëmendje përmbajtjen e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe konkretisht pikën 5 të nenit D që sanksionon: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra [...]”, si dhe pikën 4 të nenit Dh, sipas të cilit: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet [...]”, të cilat rezultojnë detyruesisht të aplikueshme në çështjen në fjalë. Veç të tjerash, rezulton se roli, vlefshmëria juridike dhe korrektësia e këtyre normave në harmoni me frymën e reformës në drejtësi, është analizuar, argumentuar dhe konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese përgjatë shqyrtimit të çështjes së përfunduar me vendimin nr. 2/2017 (p. 46 dhe 47).

III. Shkaqet e ankimit

9. Ndaj vendimit të Komisionit, brenda afatit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se vendimi është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në drejtim të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, si dhe duke pretenduar që për shkak se nuk ishte në ushtrim funksioni, nuk ishte subjekt i ligjit nr. 84/2016, e për shkak të mungesës së cilësisë së subjektit, kjo çështje nuk mund të shqyrtohej nga Komisioni, dhe vendimi duhet të priset si dhe shqyrtimi duhet të pushohet. Shkaqet janë paraqitur në ankim, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

9.1 Në drejtim të procesit të rregullt ligjor:

- a) Subjekti pretendon se nuk është kryer hetim i plotë dhe i gjithanshëm sa i takon mosmarrjes dhe mosadministrimit në dosje të përgjigjes së ILDKPKI-së.
- b) Vendimi i Komisionit pretendohet se është tërësisht i paligjshëm dhe i paarsyetuar.
- c) Subjekti pretendon se Komisioni ka tejkaluar kompetencat dhe ka bërë referim të gabuar në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 2/2020.
- ç) Sipas subjektit, Komisioni dukshëm shtrembëron faktet dhe tregon dashakeqësi.

9.2 Për themelin:

- a) Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, pretendon se Komisioni është inkoherent dhe kontradiktor sa i takon kualifikimit të saj si gjyqtare apo ish-gjyqtare.
- b) Gjithashtu, ka pretenduar se nuk është subjekt rivlerësimi, pasi nuk ka qenë në ushtrim detyre në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, në këtë moment ushtronte aktivitet privat, dhe ka aplikuar duke u kualifikuar si “kandidat gjyqtar⁴” pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

⁴ Znj. Beçaj ka aplikuar në vitin 2017, për të qenë pjesë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është listuar si kandidate që plotëson kriteret formale, por nuk është përzgjedhur.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* të paraqesë ankim ndaj vendimeve të Komisionit, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Ankimi është ushtruar nga subjekti i rivlerësimit dhe, në bazë të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit nga Kolegji ndaj vendimit nr. 270, datë 03.07.2022, të Komisionit, bëhet në dhomë këshillimi.

12.1 Gjithashtu, duke qenë se nuk gjendemi përpara rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 20 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, gjykimi në Kolegj kryhet në dhomë këshillimi.

12.2 Subjekti ka paraqitur pranë Kolegjit, nëpërmjet parashtrimeve të datës 14.10.2022, akte të cilat nuk i kishte depozituar më parë në Komision, por që nuk ka kërkuar marrjen e tyre në mënyrë eksplicite në shqyrtim. Kolegji konstatoi se aktet e paraqitura nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga dispozita e nenit 47⁵ të ligjit nr. 49/2012 për të gëzuar statusin e provës së re për marrjen në shqyrtim.

V. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

13. Subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, ka pretenduar se Komisioni nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm sa i takon mosmarrjes dhe mosadministrimit në dosje të përgjigjes së ILDKPKI-së, për të provuar që për shkaqe të pavarura prej saj, nuk ka dorëzuar deklaratat pranë organeve ndihmëse.

13.1 Me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike, Kolegji ka marrë në shqyrtim këtë pretendim dhe, në bazë të nenit 14, pika 5, germet “a” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. {***}prot., datë 17.10.2022, “Kërkesë për informacion”, i kërkoi Komisionit informacion shtesë mbi këtë pretendim. Pas kësaj kërkesë, Komisioni ka përcjellë shkresën nr. {***} prot., datë 30.01.2020, “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”, nëpërmjet së cilës rezultoi se ka kërkuar nga ILDKPKI-ja kopjen e Deklarimit Vjetor të Pasurisë të vitit 2018 për disa subjekte, midis tyre edhe për subjektin e rivlerësimit. Në vijim, nuk rezultoi që ILDKPKI-ja të këtë dhënë informacion tjetër rreth gjendjes apo situatës për znj. Shpresa Beçaj.

13.2 Komisioni, gjatë hetimeve paraprake dhe me relacionin mbi rezultatet e hetimit të datës 10.03.2020, ka konstatuar që subjekti nuk ka depozituar deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 pranë ILDKPKI-së, dhe dokumentacionin shoqërues për të mundësuar vlerësimin profesional,

⁵ Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj

duke u shprehur se: [...] duket se mosparaqitja e deklaratave apo e kërkesave sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, shkakton humbjen e cilësisë/subjektit të rivlerësimit [...]. Në këto kushte, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, nuk ka paraqitur prova apo rrethana të pavarura prej saj, që kanë shkaktuar pamundësinë e paraqitjes së deklaratave. Në udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 4905 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, në pikën 2, paragrafi 3⁶, parashikohej se të gjitha subjektet duhet të paraqiteshin personalisht pranë ILDKPKI-së për të dorëzuar deklaratat e më pas të pajiseshin me vërtetimin përkatës [të dorëzimit].

13.3 Në dosjen hetimore, janë të administruara komunikimet shkresore midis Komisionit dhe organeve ndihmëse, KLGj dhe DSIK, si vijojnë.

13.3.1 Shkresa e Komisionit nr. {***} prot., datë 19.01.2020, nëpërmjet së cilës i kërkohet KLGj-së: [...] do të vlerësonim nëse ju do të na bënit me dije se cili ka qenë statusi i kësaj gjyqtareje në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, dhe nëse ajo ka paraqitur dokumentacionin përkatës për rivlerësimin kalimtar [...].

13.3.2 Kësaj shkrese, KLGj-ja i është përgjigjur se: [...] Për sa më sipër, konstatohet se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, pra më datë 09.10.2016, znj. Beçaj (i) kishte mbaruar mandatin si anëtare e Gjykatës së Lartë, respektivisht më datë 23.03.2013; dhe (ii) dispononte vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, datë 26.07.2016, i cili nuk ishte i formës së prerë [...]. Sa më sipër, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, gjyqtare Shpresa Beçaj nuk ishte një gjyqtare në ushtrim detyre [...], duke vijuar më tej: [...] Me hyrjen në fuqi të ligjit nga ana e Inspektoratit të KLD-së, është proceduar hapja e një regjistri të posaçëm manual, ku janë hedhur të dhënat mbi subjektin, po ashtu dokumentacionin e dorëzuar. Duke iu referuar të dhënave në regjistrin e posaçëm të administruar në KLD dhe tashmë pranë KLGj-së, rezulton se në periudhën 21.10.2016 – 31.03.2017, nuk rezulton të jenë depozituar formularë dhe dokumentacion shoqërues për vlerësimin profesional nga znj. Shpresa Beçaj⁷. Nga regjistri i posaçëm, dërguar bashkëlidhur kësaj shkrese, rezulton që në të, nuk është i pasqyruar emri i subjektit të rivlerësimit.

13.3.3 Po ashtu, është e administruar kërkesa e Komisionit nr. {***} prot., datë 04.02.2020, që i kërkon informacion DSIK-së: [...] ju kërkohet të na bëni me dije nëse znj. Shpresa Beçaj ka paraqitur, pranë institucionit tuaj, deklaratën për kontrollin e figurës [...], dhe në vijim, DSIK⁸ bën me dije se: Znj. Shpresa Beçaj, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në DSIK, duke rezultuar kështu në mosdorëzim nga subjekti, të deklaratës së kontrollit të figurës.

13.4 Në vështrim të dispozitave ligjore në fuqi, Kolegji vlerëson se nuk ka ekzistuar pengesë ligjore që të pamundësonte subjektin e rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, që të dorëzonte deklaratat pranë organeve ndihmëse, brenda afatit të përcaktuar. Dispozitat e ligjit nr. 84/2016, neni 31, pika 1, neni 35, pika 1, dhe neni 41, pika 1, lexuar në harmoni me dispozitat e nenit D, pika 5

⁶ Dorëzimi i deklaratës së pasurisë duhet të bëhet nga vetë subjekti, në protokollin e ILDKPKI-së, ku do të pajiset me vërtetim përkatës për dorëzimin e deklaratës dhe fletëve të inventarit për dokumentacionin justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë

⁷ Shkresa e KLGj-së nr. {***} prot., datë 24.02.2020, “Kthim përgjigje [...]”.

⁸ Shkresa e DSIK-së nr. {***} prot., datë 17.02.2020, “Kthim përgjigje” (e klasifikuar: sekret).

dhe Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, parashikojnë se subjektet kanë detyrimin ligjor të provojnë çdo pengesë që passjell mosdorëzimin e deklaratave dhe në rast se nuk provojnë shkakun që ka penguar paraqitjen, si pasojë kanë masë disiplinore shkarkimin nga detyra. Afati ligjor i përcaktuar për dorëzimin e këtyre deklaratave, me pezullimin e efekteve të ligjit nr. 84/2016, ishte deri më datë 31.03.2017. Dorëzimi i këtyre deklaratave është pikënisja e procesit të rivlerësimit për secilin subjekt, parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, përfshirë këtu edhe ata që nuk ishin në ushtrim detyre dhe aspironin që të riktheheshin në detyrë.

13.4.1 Në çështjen objekt gjykimi, rezulton se përveç faktit se subjekti nuk i ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratat, atë të vlerësimit profesional dhe atë të figurës, hetimi, duke kërkuar konfirmim për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nuk do të kënaqte parashikimet e neneve D dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës, pasi ky fakt nuk do të ndikonte në vendimmarrjen e Komisionit, e tashmë as të Kolegjit. Fakti që subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, nuk i ka dorëzuar deklaratat, është pranuar prej saj dhe është i pakontestueshëm e për rrjedhojë i panevojshëm të provohet.

13.4.2 Për sa më lart, Kolegji konkludon se në bazë të nenit Dh, pika 4⁹ e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 31, pika 1, nenit 35, pika 1 dhe nenit 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, konfirmimi nga DSIK-ja dhe KLGj-ja, që nuk janë dorëzuar deklaratat e kontrollit të figurës dhe ato profesionale, janë në favor të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, dhe i shërben Komisionit të mbështesë vendimmarrjen, dhe përmbush kushtin për shkarkim nga detyra¹⁰.

- 14.** Subjekti ka pretenduar gjithashtu se *vendimi i Komisionit është tërësisht i paligjshëm dhe i paarsyetuar*, duke e mbështetur këtë pretendim kryesisht në rezultatet e hetimeve paraprake, por pa e analizuar më tej vendimin në mbështetje të pretendimit.

14.1 Kolegji mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, nëse gjendemi përpara rasteve të paligjshmërisë së vendimit dhe nëse ishte cenuar niveli i arsyetueshmërisë së tij.

14.1.1 Ka rezultuar se Komisioni e ka shkarkuar nga detyra subjektin për shkak se është konstatuar mosdorëzimi i deklaratave nga ana e saj. Arsyetimin e tij, Komisioni e ka mbështetur në nenet D dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës, po ashtu edhe në nenet 31, 34 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet që mosdorëzimi i deklaratave përbën shkak për shkarkimin nga detyra.

14.1.2 Për nga ana formale, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se vendimi i Komisionit duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese.

- (i) Hyrja e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësin administrativ-sekretaren gjyqësore; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e

⁹ Neni Dh/4: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

¹⁰ Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 10/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit A. Thanza, paragrafi 1, faqe 15: “[...] Në procesin e rivlerësimit, tri nene të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë prezumimin në favor të masës disiplinore të pezullimit ose shkarkimit. Konkretisht, nenet D, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurive; Dh, pikat 3 dhe 4, që kanë të bëjnë me kontrollin e figurës; dhe E, pikat 3, 4 dhe 5 që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale”.

subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesit të saj; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe të përfaqësuesit të saj.

- (ii) Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.
- (iii) Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.

14.1.3 Përveç sa më lart, një vendim nuk duhet të përmbushë vetëm elementet formale, por edhe ato substanciale, pra t'u japë përgjigje palëve, të marrë në analizë provat dhe faktet, të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, njëkohësisht nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar¹¹.

14.1.4 Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi objekt gjykimi i plotëson si elementet formale, edhe ato esenciale, duke arritur kështu një nivel të pranueshëm të arsyetimit të tij, duke e gjetur të pabazuar në ligj e në prova pretendimin e subjektit.

14.2 Kolegji shqyrtoi pretendimin e subjektit se *vendimi i Komisioni është i paligjshëm*, nga ku ka rezultuar se vendimi i Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, ka ardhur për shkak të mosdorëzimit të deklaratave për kontrollin e figurës, të pasurisë dhe formularit për vlerësimin profesional sipas ligjit nr. 84/2016.

14.2.1 Subjekti ka ngritur pretendimin që mosplotësimi i deklaratave pranë ILDKPKI-së ka ardhur për shkakun e sipërtrajtuar dhe se KLD-ja nuk e kishte emëruar në detyrë sipas nenit 25 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i shfuqizuar, pra siç pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, emri i saj nuk figuronte në listat e organeve ndihmëse, konkretisht në ILDKPKI. Në referim të nenit 109¹² të Kodit të Procedurave Administrative, një akt është i paligjshëm nëse nuk plotëson një nga elementet e këtij neni.

14.2.2 Kolegji çmon se nuk gjendemi në rastet e parashikuara në nenin 109 që të çojnë në paligjshmërinë e vendimit të Komisionit, pasi: (i) ai është organi i cili në bazë të ligjit nr. 84/2016, ka kompetencën për kryerjen e rivlerësimit kalimtar; (ii) nuk rezulton të jetë shkelur procedura administrative, si dhe nga subjekti nuk është parashtruar asnjë rrethanë e tillë; (iii) nuk vjen në kundërshtim me dispozita që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshëm të aktit administrativ, pra është në përputhje me nenin 57, siç analizuam më lart; (iv) nxjerrja e vendimit të Komisionit nuk ka nevojë për autorizim; (v) është zbatim i drejtpërdrejtë i ligjit material; (vi) nga ana e subjektit, por as nga Kolegji, nuk është konstatuar rrethanë që të përbëjë shkak të

¹¹ *Vendimi nr. 3, datë 19.02.2013 dhe vendimi nr. 55, datë 18.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese.*

¹² "[...] a) organi publik që e ka nxjerrë, ka vepruar në mungesë të kompetencës; b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2 të nenit 4 të këtij Kodi; d) është në kundërshtim me ligjin material; dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit".

ushtrimit të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme; si dhe (vii) nuk rezulton që Komisioni të ketë tejkaluar parimin e proporcionalitetit, një pretendim i tillë nuk është ngritur as nga subjekti.

14.3 Në lidhje me pretendimin e tejkalimit të kompetencave dhe referimit të gabuar në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 2/2020, Kolegji analizoi pretendimet e subjektit, vendimin e Komisionit, si dhe pretendimin se efektet e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, shtrihen pas datës së nxjerrjes së aktit të emërimit në detyrë nga KLD-ja, pra pas datës 04.06.2018.

14.3.1 Tejkalimin e kompetencave, subjekti e lidh me faktin që Komisioni është shprehur rreth vendimmarrjes së KLD-së për ta emëruar në detyrë, duke arsyetuar: [...] *Gjithashtu, vërehet se edhe emërimi i znj. Shpresa Beçaj në Gjykatën e Apelit Tiranë, që është konkretizuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, është bazuar pikërisht mbi ekzistencën e këtij statusi, të konfirmuar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendim të formës së prerë – përpos faktit se ky emërim jo vetëm që ka qenë tejet i vonuar, por duket sikur është kryer në kapërcim të kompetencave të KLD-së, për sa kohë këto të fundit rezultonin të pezulluara nga dispozitat tranzitore që kishin hyrë në fuqi përpara emërimit në fjalë [...]*¹³. Deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, më datë 22.11.2016, ishte KLD-ja organi që duhet të kryente, veç të tjerave, emërimet në detyrë të gjyqtarëve. Ka rezultuar që me ligjin nr. 96/2016, në nenin 160, pika 1, është parashikuar se KLD-ja deri në krijimin e KLGj-së, do të emëronte në detyrë dhe të transferonte vetëm magjistratët e diplomuar në vitin 2016; mund të vendoste masa disiplinore; mund të pezullonte gjyqtarët; kryente mbikëqyrjen e trajnimeve; vlerësimin e punës dhe transferimin e përkohshëm të gjyqtarit për plotësimin e trupës. Ky konstatim i situatës ligjore nga Komisioni, që ka ndodhur në momentin e emërimit të subjektit në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk cenon vlefshmërinë e aktit të emërimit në detyrë dhe, njëkohësisht, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, përveçse konfirmon të drejtat, nuk ndryshon situatën e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit.

14.3.2 Ka rezultuar që emërimi i subjektit të rivlerësimit në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë më datë 07.05.2018, është bërë në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Zbatimi dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është pjesë e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së. Edhe ekzekutimi dhe zbatimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për emërimin e subjektit të rivlerësimit në detyrë, nga ana e KLD-së vlerësohet në këtë kuadër, pavarësisht faktit se ndryshimet ligjore në kuadër të reformës në drejtësi, tagrin e emërimit në detyrë të gjyqtarëve ia kaloi KLGj-së, e cila në atë moment nuk ishte konstituuar¹⁴. Pra, nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 e deri në konstituimin e KLGj-së ligjërisht, nuk mund të kryheshin emërimet në detyrë, për gjyqtarë të ndryshëm nga ata të diplomuar në vitin 2016, siç referuam më lart. Në këtë kontekst, vlerësohet se Komisioni ka analizuar emërimin e subjektit më datë 07.05.2018 nga ana e KLD-së, si emërim që është bërë në kuadër të zbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke mbajtur në konsideratë edhe konkluzionet e GjEDNj-së në çështjen Driza kundër Shqipërisë¹⁵.

¹³ Vendimi i Komisionit objekt gjykimi, faqe 7, para. 31.

¹⁴ KLGj-ja është konstituuar më datë 12.12.2018, referuar vendimit të saj nr. 4, datë 20.12.2018, "Mbi deklarimin e krijimit të KLGj-së".

¹⁵ Para. 122: https://www.gjk.gov.al/web/C_SHTJA_DRIZA_KUND_R_SHOIP_RIS_ANKIMI_NR_33771_02_181_1.php.

14.4 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka referuar në mënyrë të gabuar në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 2/2020¹⁶, Kolegji çmon se nuk është i bazuar. Konstatohet se Komisioni është shprehur: *Lidhur me faktin që, për subjektet që gëzojnë ipso jure statusin e magjistratit, mosushtrimi i detyrës nuk përbën shkak për përjashtimin e tyre nga procesi i rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit – (vendimi nr. 2/2020, para. 16.3)*¹⁷, duket se referenca ka ndodhur pasi në vendimin e Kolegjit (JR) 2/2020, është arsyetuar ndër të tjera se fakti i mosushtrimit të detyrës nga subjekti, nuk përbën shkak për mbarimin e statusit të magjistratit, duke e lidhur kështu me situatën në të cilën ndodhej subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, pasi edhe ajo nuk ishte në ushtrim detyre në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, dhe nuk kishte një vendim që të deklaronte të mbaruar statusin.

14.5 Po ashtu, në lidhje me pretendimin e subjektit për *dashakeqësi të Komisionit*, rezulton që në vendimmarrjen dhe procesin e ndjekur në Komision, nuk është paraqitur situatë që ka shërbyer për të krijuar bindjen e subjektit që Komisioni gjendet në kushte të dashakeqësisë ndaj saj. Dashakeqësia shprehet në formën e njëanshmërisë së trupës gjyquese, në drejtim të rëndimit/përkeqësimit të situatës, dhe në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji nuk evidenton elemente të cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, po ashtu nga subjekti nuk është konkretizuar rrethana që i ka krijuar bindjen dhe dyshimin e ekzistencës së një elementi të tillë. Rezulton se Komisioni i ka dhënë kohë subjektit për të përgatitur mbrojtjen, e ka njohur me dosjen, ka shtyrë seancat sipas kërkesave të subjektit, në asnjë moment nga subjekti nuk rezulton të jetë ngritur si pretendim që trupa nuk është e paanshme apo dashakeqëse.

B. Mbi themelin e çështjes

i. Qenia ose jo e znj. Shpresa Beçaj subjekt rivlerësimi

- 15.** Gjatë procesit në Komision, kërkimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, kanë konsistuar në faktin se paçka se e konsideronte veten gjyqtare, ajo nuk ka qenë në ushtrim të detyrës, për shkak të mosveprimit të organeve kompetente dhe *situata e saj ishte e veçantë*, e për këtë shkak nuk mund t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Duke theksuar po ashtu se vullneti i saj ishte që të rivlerësohej si gjyqtare, dhe jo si ish-gjyqtare, *për këtë arsye, arsyeton subjekti, nuk ka paraqitur kërkesë sipas pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, dhe njëkohësisht ka vijuar kërkimin e rehabilitimit të statusit nëpërmjet rrugës gjyqësore.*
- 16.** Kolegji vlerëson se neni 179/b i Kushtetutës, në lidhje me pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, janë dy dispozitat që kanë përcaktuar rrethin e subjekteve që do t'i nënshtrohen rivlerësimit kalimtar sipas ligjit të posaçëm nr. 84/2016. Për të arritur në konkluzionin nëse znj. Beçaj duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, dhe për t'i dhënë zgjidhje themelit të çështjes, Kolegji mori në analizë pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, e cila referon në nenin 179/b të Kushtetutës.

[¹⁶] Kolegji është shprehur: “16.3 [...] Pra, ligji e ndan konceptin e “emërimit si magjistrat” dhe “magjistratit në detyrë apo pozicion” si në rastin e subjektit, i cili edhe pse nuk ushtron detyrën e magjistratit, vijon të ketë emërimin dhe statusin e magjistratit. Rastet e mbarimit të statusit të magjistratit dhe procedura parashikohen në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, ndaj emërimi i subjektit si anëtar i KLP-së nuk prezumon mbarimin e statusit të magjistratit”.

[¹⁷] Vendimi i Komisionit objekt gjykimi, faqe 8, para. 1.

16.1 Pika 16 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar se: “*Subjekt i rivlerësimit*” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”, dhe neni 179/b i Kushtetutës, në pikat 3 dhe 4 ka parashikuar se: “3. Të gjithë gjyqtarët [...] i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. 4. [...] Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët [...] të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Pika 3 e nenit 179/b të Kushtetutës iu referohet të gjithë gjyqtarëve të cilët e mbajnë statusin e magjistratit/gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ndërsa fjalia e dytë e paragrafit 4 iu referohet ish-gjyqtarëve që nuk e kanë statusin, por kanë punuar të paktën tre vjet në këto pozicione, dhe nëpërmjet kërkesës, pasi të kalojnë procesin e rivlerësimit, mund të rikthehen në sistem, pra diferenca midis cilësisë së gjyqtarit dhe ish-gjyqtarit, është statusi i magjistratit në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave.

16.2 Për të verifikuar rëndësinë që ka statusi i gjyqtarit në aspektin e sigurisë juridike, dhe gëzimi i tij nga personat të cilët e kanë fituar, Kolegji mori në analizë në mënyrë sistematike dhe të shtrira në kontekstin historik dispozitat që kanë rregulluar cilësinë/statusin e gjyqtarëve që në momentin që subjekti i rivlerësimit e ka fituar këtë status.

16.3 Paprekshmëria e statusit të gjyqtarit/magjistratit, është një e drejtë dhe siguri e shtuar që lidhet me ushtrimin e detyrave funksionale në mënyrë të pavarur, e sanksionuar që në nenet 9 dhe 28¹⁸ të dekretit nr. 7174/1987 “Për organizimin gjyqësor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, akt i cili rregullonte funksionimin e pushtetit gjyqësor në vitin 1987, në kohën kur subjekti e kishte fituar statusin e gjyqtarit me emërimin në detyrë, ku parashikohej, ndër të tjera, se largimi nga detyra i gjyqtarëve bëhej për shkaqe të arsyeshme dhe me vendim të zgjedhësit.

16.4 Më tej, në ligjin nr. 7574. datë 24.6.1992, “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”¹⁹, emërimi në detyrë i gjyqtarëve bëhej nga KLD-ja, dhe pas emërimit në detyrë, gjyqtari gëzonte imunitet, nuk mund të lëvizte nga detyra, përveç rasteve të caktuara specifikisht në ligj dhe me vendim të KLD-së²⁰. Të njëjtat kushte emërimi dhe humbjeje të statusit kanë qenë parashikuar edhe në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998,

¹⁸ **Neni 9** – “[...] Gjyqtari dhe ndihmësgjyqtari mund të hiqen nga detyra vetëm kur vendosin zgjedhësit, ose organi që i ka zgjedhur, kur transferohen, kur kërkojnë vetë për shkaqe të arsyeshme, ose kur dënohen penalisht”.

Neni 28 – “Gjyqtarët e të gjitha instancave dhe ndihmësgjyqtarët e Gjykatës së Lartë gëzojnë paprekshmëri. Ata nuk mund të arrestohen, ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, me përjashtim të rasteve kur kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë”.

¹⁹ **Neni 17** – “Mund të punojnë si gjyqtarë, prokurorë personat që kanë shtetësi shqiptare, janë diplomuar si juristë, gëzojnë të drejta të plota dhe kanë figurë të pastër morale [...]”.

²⁰ **Neni 19** – “Gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit largohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kur kryejnë një vepër penale, bëhen të paafte nga ana shëndetësore, nuk fitojnë provimin periodik profesional, për shkelje të rëndë të disiplinës në punë, si dhe për cenim të figurës morale”.

Neni 20 – “Për shkelje të disiplinës në punë ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, merren këto masa: 1- Vërejtje. 2- Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra. 3- Pezullim nga puna deri në gjashtë muaj. 4- Transferim. 5- Largim nga detyra. Masat disiplinore të parashikuara nga pikat 3, 4 5 të këtij neni jepen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me kërkesën e ministrit të Drejtësisë [...]”.

Neni 21 – “Gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit që i ka zgjedhur ose emëruar. Ata mund të ndalohen pa këtë pëlqim vetëm në rastet kur kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë”.

“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”²¹. Në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar (*i cili ka qenë në fuqi deri më datë 22.11.2016*), neni 12, pika 1 parashikonte se “gjyqtari” në gjykatën e shkallës së parë dhe në Gjykatën e Apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe në referim të nenit 11²² të po këtij ligji, duhet të plotësoheshin kushtet për emërim. Edhe në këtë ligj ishte sanksionuar paprekshmëria e statusit të gjyqtarit dhe palëvizshmëria e tij, si garancia që u jepej gjyqtarëve në momentin që ata emëroheshin në detyrë²³, dhe rastet kur mund të humbte statusi.

16.5 Aktualisht, në ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, në nenin 2, germa “gj”, parashikohet që “magjistrat” është gjyqtari që ka përfitime dhe trajtim të veçantë gjatë ushtrimit të funksionit për shkak të tij [statusit], paprekshmërisë së pagës, pensionit suplementar, shpërblimeve²⁴ etj. Mbarimi i statusit, parashikuar në nenet 64²⁵ – 67 të këtij ligji, ndodh vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj, i cili deklarohet i mbaruar me vendim të këshillit kompetent.

17. Në këtë këndvështrim, konkludohet se cilësia, pra qenia “magjistrat/gjyqtar” fitohet në momentin e emërimit në detyrë, sipas procedurave që ndiqen nga organi kompetent, pasi plotësohen kriteret ligjore. Në momentin që një gjyqtar emërohet në detyrë, gëzon status të veçantë, i cili përfshin garancitë për palëvizshmërinë nga detyra, mbrojtje të veçantë nga shteti për vete, familjen dhe pronën, gëzon një pagë që nuk mund të ulet/cenohet, cilësia e gjyqtarit mbaron vetëm me akt të organit të përcaktuar me ligj dhe për shkaqet e përcaktuara ligjore, po ashtu me këtë status i vinin edhe detyrimet, që përfshijnë papajtueshmërinë, ndër të tjera, edhe me funksione politike e private. Kjo cilësi, e konsideruar edhe si “statusi i gjyqtarit ose prokurorit”, gëzohet prej tyre që nga momenti i emërimit në detyrë dhe humbet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj, dhe ekskluzivisht me akt të organit kompetent.
18. Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, datë 11.08.2016, dhe të ligjit nr. 84/2016, datë 08.10.2016, kur është caktuar rrethi i subjekteve që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, rezultoi se për znj. Beçaj: (i) nuk kishte të administruar ndonjë akt të

²¹ **Neni 22** – “Kandidatët për gjyqtarë emërohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë mbi bazën e konkurimit [...]”.

Neni 26 – “Gjyqtarët gëzojnë imunitet [...]”.

Neni 38 – “Gjyqtarët kanë të drejtë: 1. Të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme. 2. Të përfitojnë falas fletoret zyrtare, gazetat dhe revistat juridike”.

Neni 43 - “Masat disiplinore ndaj gjyqtarëve merren nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në bazë të vlerësimit të llojit dhe të karakterit të shkeljes së kryer [...]”.

²² **Neni 11** – “Kushtet për t’u emëruar gjyqtar - 1. Gjyqtar mund të emërohet shtetasi shqiptar, që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë me arsim të lartë juridik; c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës; ç) të mos jetë dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale”.

²³ **Neni 20** - “Palëvizshmëria e gjyqtarit - Gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur: a) jep dorëheqjen; b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension; c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; ç) shkarkohet nga detyra”.

Neni 34 - “Procedimi disiplinor i gjyqtarit - 1. Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka ministri i Drejtësisë [...]”.

²⁴ Nga neni 6 deri në nenin 26 e vijim të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

²⁵ **Neni 64/1** – “Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën 67 vjeç; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën”.

organit kompetent që deklaronte të mbaruar statusin e magjistratit/gjyqtarit; (ii) gjendej në një proces gjyqësor me KLD-në; dhe (iii) njëkohësisht ushtronte profesionin privat. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. {***}, datë 05.04.2017, i njohu znj. Beçaj të drejtat që buronin nga pasja e statusit të gjyqtarit, dhe KLD-ja, në zbatim të këtij vendimi, e ka emëruar subjektin e rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 34, datë 07.05.2018, “Mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për zonjën Shpresa Beçaj”.

19. Në vijim të zbatimit të këtij vendimi, në momentin kur Komisioni ka kryer procedurat e shpërndarjes së shortit dhe nisjes së procesit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj ushtronte efektivisht funksionet e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, e për rrjedhojë ndaj saj nisi procesi i rivlerësimit kalimtar. Cilësia e ish-gjyqtares në rastin e znj. Beçaj, përveç faktit që statusi i saj nuk është mbaruar/humbur, përjashtohet edhe për faktin se nga ana e saj nuk është paraqitur kërkesa për t’iu nënshtruar rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtare, që është një kusht i domosdoshëm për nisjen e procesit sipas nenit 179/b, pika 4²⁶ e Kushtetutës. Duke qenë se në këtë moment [në momentin e caktimit të rrethit të subjekteve që do t’i nënshtroheshin rivlerësimit kalimtar nga organet e posaçme më datë 11.08.2016], nuk është administruar ndonjë vendim i KLD-së që të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, arrihet në përfundimin që pavarësisht se znj. Shpresa Beçaj nuk ishte në ushtrim detyre, për shkaqe të pavarura prej saj, ajo gëzonte statusin e magjistrates.
20. Gjatë seancës dëgjimore, por edhe nëpërmjet parashtrimeve, subjekti është shprehur se përgjatë gjithë periudhës, që nga momenti i përfundimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës së Lartë, e derisa është emëruar në detyrë në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, e ka konsideruar veten “gjyqtare”, ndaj edhe nuk ka paraqitur kërkesën për rivlerësim në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, në cilësinë e ish-gjyqtares. Kolegji vëren se konkludimi i Komisionit që: [...] *përforcohet bindja se znj. Shpresa Beçaj përfshihet ndër subjektet ex officio, të parashikuara nga pika 4 e nenit 179/b*²⁷, nuk është i mbështetur në situatën faktike, pasi nuk është administruar akt i KLD-së apo KLGj-së që të ketë deklaruar të mbaruar statusin e magjistrates për znj. Beçaj, njëkohësisht edhe për faktin që znj. Beçaj nuk i ka paraqitur deklaratat dhe kërkesën për rivlerësim si ish-gjyqtare.
21. Nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, në seancën dëgjimore në Komision, është parashtruar gjithashtu qëndrimi se situata e saj nuk kishte një rregullim ligjor, pasi *ishte e veçantë për shkak të mosqenies në ushtrim funksioni*. Në zbatim të nenit 25²⁸ të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar, me mbarimin e mandatit si anëtare e Gjykatës së Lartë, znj. Beçaj kishte paraqitur kërkesën që të emërohej në Gjykatën e Apelit. Pavarësisht nëse kërkesa e subjektit u trajtua apo jo nga organet kompetente, Kolegji vlerëson se në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese më datë 11.08.2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, nuk e kishte humbur statusin e gjyqtares, edhe pse nuk ishte e emëruar në detyrë. Në të njëjtën kohë, Kolegji nuk gjen ndalim ose rast përjashtimor të caktuar në ligj ku të parashikohej mundësia për të mos plotësuar dhe për të mos dorëzuar deklaratat. Situata e subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, për Kolegjin është e qartë, pasi, për aq kohë sa nuk është

²⁶ “[...] Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet”.

²⁷ Vendimi objekt gjykimi ka shprehur: “[...] 33. Për më tepër që, edhe nga një këndvështrim më i gjerë, duke pasur parasysh frymën e dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, që synojnë rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve – dhe jo vetëm – duke përfshirë edhe ata të cilët kanë pasur më herët një të kaluar profesionale si gjyqtarë, prokurorë apo këshilltarë ligjorë (ish...), dhe aspirojnë të rikthehen si aktorë në sistemin e drejtësisë, ndonëse ndërkohë e kanë humbur statusin e mëparshëm, përforcohet bindja se znj. Shpresa Beçaj përfshihet ndër subjektet ex officio, të parashikuara nga pika 4 e nenit 179/b [...]”.

[²⁸] Me plotësimin e mandatit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 136, pika 3 e Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, me kërkesën e tij, emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.

deklaruar i mbaruar statusi i magistrates/gjyqtares, ajo përfshihet në rrethin e subjekteve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës.

22. Kolegji çmon se edhe në rast se KLD-ja, apo eventualisht KLGj-ja, (i) nuk do të kishte ekzekutuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, që konfirmonte të drejtën ligjore të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar në apel, por edhe nëse subjekti (ii) nuk do të kishte nisur proces gjyqësor, për atë kohë sa nuk rezultonte i administruar një akt që deklaronte të mbaruar statusin e magistratit, përsëri subjekti do të konsiderohej “subjekt rivlerësimi” në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. E drejta i buronte subjektit nga neni 138²⁹ i Kushtetutës [në fuqi në kohën kur subjekti i rivlerësimit kishte fituar të drejtat], dhe neni 25 i ligjit nr. 8588/2000, ku parashikohet detyrimi ligjor i organeve për të ndërmarrë procedurat për ofrimin e garancive të cilat këto subjekte i gëzonin në momentin që ushtronin detyrën/mandatin, sipas këtij ligji. Statusi i gjyqtarit është një e drejtë që nuk humbet me veprime konkludente, atëherë gjendur në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, për shkak të pritshmërisë së ligjshme që i buronte nga neni 25 i këtij ligji, kishte paraqitur kërkesën e saj për zbatim të kësaj dispozite. Kolegji vlerëson se për atë kohë sa nuk ekzistojnë të provuara kushtet që parashikojnë mbarimin e statusit të magistratit/gjyqtarit me vendim të arsyetuar, dhe subjekti gjendet përpara ekzistencës së të drejtës materiale që i garanton vijueshmërinë profesionale në sistemin e drejtësisë, pavarësisht sjelljes procedurale të organeve administrative, subjekti konsiderohet magistrat/gjyqtar edhe për efekt të procesit të rivlerësimit.
23. Në çështjen Baka kundër Hungarisë³⁰, GjEDNj-ja ka arsyetuar se në rast se në momentin e emërimit dhe ushtrimit të detyrës, gjyqtari gëzon një të drejtë kushtetuese, atëherë kjo e drejtë nuk mund të kufizohet me ligj. Po ashtu, në rastin objekt shqyrtimi, duke qenë se në bazë të nenit 138 të Kushtetutës, gjyqtari/magjistrati kishte të garantuar kohën e qëndrimit në detyrë, e cila nuk mund të kufizohet, atëherë kjo e drejtë nuk mund t'i hiqet apo kufizohet, përveçse në rast të vërtetimit të shkaqeve të përcaktuara shprehimisht në ligj.
24. Po ashtu, në çështjen Gurov kundër Moldavisë³¹ dhe Miracle Europe KFT kundër Hungarisë³², GjEDNj-ja ka theksuar se në kontekstin e nenit 6 të Konventës, organizimi gjyqësor nuk varet nga diskrecioni i organit ekzekutiv, pasi në të kundërt do të cenohej parimi i një gjykate të krijuar me ligj.
25. Ashtu siç pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ka marrë formë të prerë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, sanksionuar me ligjin nr. 76/2016, por ky vendim nuk e cenon e as ndryshon statusin e subjektit përkundrejt procesit të rivlerësimit, dhe për Kolegjin nuk ka relevancë në zgjidhjen e çështjes, përveçse konfirmon qëndrimin që znj. Beçaj e kishte statusin e magistrates. Kështu, gjendur përpara faktit se subjekti i rivlerësimit kishte ndërmarrë të gjitha veprimet për të fituar të drejtat që pengojnë t'i gëzonte, siç është konkluduar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, pavarësisht se kërkesa e saj u trajtua apo jo nga organet që kishin detyrimin ligjor të zbatimit të ligjit të kohës, gjithashtu, duke

²⁹ *Neni 138 – “Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen”.*

³⁰ *“108. Për më tepër, mbrojtja e së drejtës së kërkuesit për të shërbyer mandatin e tij të plotë si kryetar i Gjykatës së Lartë, u mbështet nga parimet kushtetuese në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve. Neni 48 § 3 i Kushtetutës së 1949 përcaktonte se gjyqtarët mund të shkarkoheshin nga detyra vetëm për arsye dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj. Neni 50 § 3 i Kushtetutës garantonte pavarësinë e gjyqtarëve (shih paragrafin 38 më lart).*

109. Prandaj, në dritën e kuadrit legjislativ vendas në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij dhe gjatë mandatit të tij, Gjykata vlerëson se kërkuesi mund të pretendonte në mënyrë të argumentuar se kishte të drejtë sipas ligjit hungarez për mbrojtje kundër largimit nga detyra e tij si president i Gjykatës së Lartë gjatë asaj periudhe”. (<https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-163113>)

³¹ *“34. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, objekti i termit “e krijuar me ligj” në nenin 6 të Konventës, është të sigurojë që “organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet nga diskrecioni i ekzekutivit, por ai rregullohet me ligj që buron nga Parlamenti”.* (<https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-76297>)

³² *Paragrafi 51 dhe 52: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-159926>.*

vlerësuar se organi që kishte kompetencën për mbarimin apo humbjen e statusit nuk kishte nxjerrë një akt që të deklaronte humbjen apo mbarimin e statusit [deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë 11.08.2016, për shkaqet e parashikuara në ligj], Kolegji vlerëson se për shkak se deklarimi i mbarimit apo humbjes së statusit të magjistratit/gjyqtarit është kompetencë ekskluzive e Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe vetëm për rastet e përcaktuara shprehimisht në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, atëherë ai nuk mund të humbë nga mosveprimi apo nga veprimet konkludente. Sipas nenit 64, edhe nëse konstatohen shkaqe të papajtueshmërisë së funksionit të magjistratit [siç pretendohet në mënyrë indirekte nga subjekti i rivlerësimit se ka ndodhur për shkak të ushtrimit të aktivitetit privat në fushën ligjore], përsëri, duhet që organi kompetent, në rastin konkret Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendim të arsyetuar, të deklarojë të mbaruar statusin e magjistratit.

26. Në të njëjtën mënyrë, Kolegji analizon edhe aplikimin e subjektit të rivlerësimit pranë Avokatit të Popullit, më datë 07.02.2017, për të qenë pjesë e organeve të sistemit të rivlerësimit. Aplikimi është një e drejtë që mund ta ushtronin të gjithë individët që plotësonin kriteret formale, dhe fakti që znj. Beçaj është kualifikuar për të vijuar me fazën tjetër, nuk e cenon statusin e saj të magjistrates. Ndryshe do të ishte situata nëse znj. Beçaj do të ishte emëruar në detyrën e “gjyqtares” pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të cilën kishte aplikuar, pasi në nenin 26, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është parashikuar që anëtari i institucionit të rivlerësimit nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit³³. Nëse do të ishte ky rasti, procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk do të nisej.
27. Në këto kushte, pavarësisht sjelljes procedurale të subjektit të rivlerësimit dhe KLD/KLGj-së, për Kolegjin rëndësi ka fakti që për shkak të Kushtetutës dhe ligjit [të kohës], znj. Shpresa Beçaj e mbartte statusin e magjistrates/gjyqtares që nga momenti që ishte emëruar në detyrën e gjyqtares, pra që në vitin 1987. Pasja e statusit të magjistrates në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, i jep asaj cilësinë e “magjistrates/gjyqtares”, dhe e bën në mënyrë të drejtpërdrejtë subjekt të ligjit nr. 84/2016, që bie nën parashikimin e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, duke e përjashtuar në mënyrë automatike cilësinë e saj si ish-gjyqtare.
28. Në analizë të nenit 179/b të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se është statusi i magjistratit/gjyqtarit ai që përcakton rrethin e subjekteve që duhet t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016. Në vlerësim të dispozitave ligjore në fuqi në kohën e fitimit të të drejtave dhe kryerjes së veprimeve, parashikohet që statusi i gjyqtarit fitohet në momentin e emërimit në detyrë dhe humbet me akt të organit kompetent, vetëm për rastet e parashikuara shprehimisht në ligj. Mbi këtë arsyetim dhe në bazë të provave të administruara, rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, e ka fituar statusin në momentin e emërimit në detyrë si gjyqtare, dhe e ka gëzuar pa ndërprerje për shkak të mandatit të gjyqtares së Gjykatës së Lartë. Rezulton e provuar dhe nuk është administruar asnjë akt i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të vërtetojë humbjen ose mbarimin e këtij statusi sipas parashikimeve ligjore të kohës.
29. Për sa më lart, Kolegji konkludon se znj. Beçaj, për shkak të pasjes së statusit të gjyqtares, përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 179/b, pika 3, pra kualifikohet si “magjistrate/gjyqtare”, dhe ajo duhej t’i nënshtrohej procesit i rivlerësimit *ex officio*, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Sa u takon detyrimeve që rrjedhin nga pasja e statusit të magjistratit*

30. Aneksi i Kushtetutës në nenin D, pika 5 dhe nenin Dh, pika 4, ka parashikuar detyrimin ligjor të të gjitha subjekteve që përfshihen në nenin 179/b të Kushtetutës, për të plotësuar dhe depozituar brenda afatit të përcaktuar deklaratat (i) e pasurisë, (ii) të kontrollit të figurës dhe (iii) formularin e vetëvlerësimit profesional, pa parashikuar raste përjashtimore apo pengesa ligjore. Deklarata

³³ “3. Anëtari i institucionit të rivlerësimit nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, sips nenit 179/b të Kushtetutës”.

vetting është dokumenti ligjor nga i cili evidentohen përgjegjësitë e subjekteve të rivlerësimit për shkelje disiplinore, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose përdorim, pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Mosplotësimi dhe mosdorëzimi në kohë i deklaratës së pasurisë dhe i deklaratës së kontrollit të figurës, brenda afatit të caktuar, ka parashikuar në mënyrë eksplicite shkarkimin nga detyra të cilitdo person që përfshihet në nenin 179/b të Kushtetutës.

31. Nga ana e Komisionit, pasi është konstatuar situata faktike, ku ka rezultuar se subjekti nuk ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë, atë të kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit profesional, nëpërmjet rezultateve të hetimeve paraprake, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të vërtetuar të kundërtën, për të paraqitur prova ose rrethana që kanë pamundësuar paraqitjen e tyre brenda afatit të caktuar. Sidoqoftë, ajo çka është e rëndësishme në këtë çështje, është fakti që znj. Shpresa Beçaj, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, paçka se jo në detyrë, ishte në kërkim të konfirmimit të së drejtës, dhe pavarësisht kësaj, me veprime konkludente zgjodhi të mos i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, duke përdorur në favor të saj një gjendje fakti të listave të KLD-së.
32. Ndodhur në kushtet kur subjekti i rivlerësimit përfshihej në rrethin e subjekteve të parashikuara në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, që duhet t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit kalimtar nga organet e posaçme, Kolegji arrin në konkluzionin se plotësimi i deklaratave është kusht *sine qua non* për zhvillimin e këtij procesi. Moszbatimi i këtij kushti, në referim të neneve D, pika 5 dhe Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, shoqëruar me mosdorëzimin e deklaratave sipas ligjit nr. 84/2016 prej tij, duke zbatuar prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sjell edhe humbjen e statusit të magjistratit/gjyqtarit.
33. Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, krahas të drejtave dhe garancive që kërkonte të realizonte nëpërmjet procesit gjyqësor për shkak të pasjes së statusit të gjyqtarës, duhet të kishte mbajtur në konsideratë edhe detyrimet ligjore që rrjedhin prej statusit, një prej të cilave ishte edhe nënshttrimi ndaj procesit të rivlerësimit. Aneksi i Kushtetutës në nenet D dhe Dh, dhe neni 31, pika 1, neni 35, pika 1 dhe neni 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 ka parashikuar detyrimin ligjor të të gjitha subjekteve që përfshihen në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, për të plotësuar dhe depozituar brenda afatit të përcaktuar deklaratat e pasurisë për rivlerësim, të kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit profesional, pa pengesë apo përjashtim të subjekteve nga ky detyrim ligjor. Nga subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur provë ose rrethanë që të ketë pamundësuar paraqitjen e deklaratave brenda afatit të caktuar. Ndaj mospërmbushja e këtij detyrimi, pra mosdorëzimi i deklaratave nga subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, në referim të neneve të mësipërme të Aneksit të Kushtetutës, përbën shkak për shkarkim nga detyra.
34. Në mbështetje të këtij konkluzioni, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit, për sa i përket faktit që znj. Shpresa Beçaj duhet të kishte dorëzuar deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe formularin e vlerësimit profesional pranë institucioneve të ngarkuara me ligj, në mënyrë që t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në ligj e në prova.
35. Në përfundim, mbështetur në sa më sipër, në zbatim të nenit 4, pikat 2 dhe 5, nenit 31, pika 1, nenit 35, pika 1 dhe nenit 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji e gjen të drejtë vendimmarrjen

e Komisionit dhe çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, që nuk duhet t'i nënshtrohej këtij procesi, duke qenë se nuk ishte gjyqtare në ushtrim detyre, nuk është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në pikën 5 të nenit D dhe pikën 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 270, datë 03.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 01.12.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi